



Datë: 19.02.2026  
Numër Protokolli: 905/2026

A.nr.164/2026

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.164/2026, të datës 12.02.2026, të parashtruar nga ankuesi D.K, kundër organit të punësimit/Komunës se Prizrenit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.02.2026, nxjerrë, këtë:

## V E N D I M

**Hedhet poshtë si e parakohshme** ankesa me numër A.nr.164/2026, e datës 12.02.2026, e parashtruar nga ankuesi D.K.

## A r s y e t i m

Ankuesi D.K (*tutje referuar ankuesi*), më datë 12.02.2026, përmes emailit [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.164/2026, kundër Njoftimit të datës 03.02.2026, të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës Prizrenit lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e pranimit me numër të referencës: RN00019150, për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë Ligjor*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të çështjes ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga shkresave e lëndës rrjedhë së Komuna e Prizrenit, me datë 23.12.2025 ka shpallur konkursin më numër të referencës: RN00019150, për pozitën e punës “*Zyrtar i Lartë Ligjor*”, me afat të aplikimit nga data 24.12.2025-22.01.2026.

Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës del së në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo, me Njoftimin e datës 03.02.2026 të Njësisë për Burime Njerëzore të Komunës se Prizrenit i është refuzuar aplikacioni për arsyetimin: “...se nuk ka bashkëngjitur dëshminë lidhur me përvojën e punës sipas kërkesës së konkursit që duhet të jetë dy (2) vite përvojë pune profesionale...”

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundërshton ligjshmërinë e Njoftimit të datës 03.02.2026 të Njesisë për Burime Njerëzore të Komunës së Prizrenit, për refuzimin e aplikacionit, më pretendimet së ka përvojën e punës profesionale në kompaninë Checchi and Company Consulting Inc në kuadër të Qendrës së Ndërmjetësimit- Prizren konkretisht nga data 17.03.2014-31.05.2015, 01.06.2015-30.06.2015, 01.07.2025-30.04.2016 me gjithsej 25 muaj e 13 dite përvojë pune profesionale, qe e njëjta konfirmohet përmes kontributeve pensionale nga Trusti Pensional i Kosovës gjithsej 27 muaj. Kërkon që vendimi të rishqyrtohet të behët rivlerësimi korrekt i përvojës se punës dhe të mundësohet vazhdimi në fazat tjera të rekrutimit.

Në kuptim të pranushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 i cili përcakton se: *“12. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”*, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit Në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: *“Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”*, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankuesit e parashtruar më datë 12.02.2026, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidatja/i për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtrroj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së rekrutimit, ndërsa, ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër njoftimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Pra, meqenëse në kohën e parashtrimit të ankesës së ankuesit të datës 12.02.2026, nuk ka përfunduar procedura e pranimit sipas konkursit numër të referencës: RN00019150, rrjedhë se ankesa e ankuesit A.nr.164/2026, e datës 12.02.2026 është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39, paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës me numër A.nr.164/2026 nuk mohon të drejtën e ankuesit që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*Lënda: A.nr.164/2026*

**Merlinda RAMAJ**

\_\_\_\_\_  
*Procesmbajtëse*

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

\_\_\_\_\_  
*Kryetare e Kolegjit*

### **Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit D.K;
- Njesisë për Burime Njerëzore të Komunës së Prizrenit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.